BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI ZYRTAR

vëllimi 8 numër 11 Tetor 2006

Data e botimit 21.10.2006

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.74, datë 11.10. 2006 "Për një shtesë në rregulloren "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 53, datë 21.06.2000 i ndryshuar" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.75, datë 11. 10. 2006 "Për miratimin e rregullores "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"" 6

3. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 1, Janar 2006 14
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 2, Shkurt 2006 14
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 3, Shkurt 2006 14
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 4, Maj 2006 15
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 5, Maj 2006 15
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 6, Qershor 2006 16
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 7, Korrik 2006 16
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 8, Korrik 2006 16
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 9, Gusht 2006 16
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 10, Shtator 2006 17

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 74, datë 11.10. 2006

PËR NJË SHTESË NË RREGULLOREN "PËR TRANSPARENCËN DHE KONFIDENCIALITETIN NË BANKËN E SHQIPËRISË", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 53, DATË 21.06.2000 I NDRYSHUAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "c" dhe "f" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave dhe të Departamentit Juridik, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në nenin 5, me titull "Përdorimi i informacionit" të rregullores "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 53, datë 21.06.2000 i ndryshuar, pas paragrafit të parë të pikës 5.2, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
   "Kriteret dhe mënyra e përdorimit të informacionit të klasifikuar "sekret bankar" nga subjektet të cilat bazuar në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", gëzojnë të drejtën të kontrollojnë llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë, përcaktohen në udhëzimin "Mbi rregullat e përdorimit dhe klasifikimin e informacionit jopublik në Bankën e Shqipërisë" dhe janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditit".
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohen të gjitha strukturat organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 75, datë 11. 10. 2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI PROCEDURAT E NDËRHYRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 2, të nenit 43, shkronjat "b" dhe "c", të nenit 60, pikat 1 dhe 2 dhe të nenit 61, shkronja "a" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës "Për krijimin e Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare", të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare", me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE

"MBI PROCEDURAT E NDËRHYRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE"

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

Neni 2
Baza ligjore

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me:

a) ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 3, pika 2; neni 43, shkronjat "a" dhe "b"; neni 60, pika 2 dhe neni 61, shkronja "a".
b) Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës "Për krijimin e Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare".
c) Rregulloren "Për organizimin edhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare".

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Spot" – është marrëveshja e këmbimit valutor, sipas të cilës palët bien dakord për kursin e këmbimit dhe kalimin e fondeve në llogaritë e secilës prej tyre , deri në 2 (dy) ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes.
b) "Forward"- është marrëveshja e këmbimit valutor, sipas të cilës palët bien dakord për kursin e këmbimit dhe për kalimin e fondeve në llogaritë e secilës prej tyre në një datë të caktuar, e cila është më tepër se 2(dy) ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes.
c) "Kuotim" – është shprehja e gatishmërisë së partnerit të tregtimit për të tregtuar një monedhë të huaj kundrejt lekut.

d) "Sterilizim" – është shitja ose blerja me të drejta të plota e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të minimizuar efektin në tregun e parasë që vjen si rezultat i ndërhyrjes në tregun valutor.
e) "Partnerët e tregtimit" - janë bankat e nivelit të dytë dhe/ose zyrat e këmbimit valutor.
f) "Qeveria" – është Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
g) "Banka" – është Banka e Shqipërisë.
h) "Procedura e ndërhyrjes" – është mënyra e propozimit, e marrjes së vendimit dhe e realizimit të ndërhyrjes në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore nga Banka e Shqipërisë.
i) "Ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor" - është ndikimi që i bën Banka kërkesës dhe ofertës për lekë ndaj monedhave të huaja.
j) "Ndërhyrja me veprim" - është çdo kontaktim me gojë ose/dhe në rrugë elektronike nga ana e Bankës me partnerët e tregtimit, me synim blerjen ose shitjen e monedhës së huaj kundrejt monedhës vendase.
k) "Ndërhyrje verbale" - është çdo deklaratë verbale apo e shkruar e Bankës në lidhje me nivelin e kursit të këmbimit të lekut kundrejt monedhave të huaja.
l) "Transaksione tregtare në tregun e brendshëm valutor" - janë blerjet ose shitjet e monedhës vendase kundrejt monedhës së huaj, të cilat nuk synojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të nivelit ose të sjelljes së kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhës së huaj, të tilla si transaksionet valutore të Qeverisë.
m) "Çrregullim i tregut të brendshëm valutor" - është :
i. mungesa e likuiditetit si rezultat i të cilës partnerët e tregtimit nuk janë në gjendje të mbajnë pozicione të hapura dhe rrezikojnë tërheqjen e tyre nga tregu, gjë që rezulton në vështirësimin e këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja;
ii. rritja e ritmit të ndryshimit në një kah e kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja ose rritja e luhatshmërisë së kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja, në kushtet e mungesës së informacionit të ri në treg;
iii. zgjerimi i diferencës midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja, të cilat kuotohen në tregun valutor;
iv. ndryshimi i përbërjes dhe i vëllimit të veprimeve që kryhen në tregun valutor;
v. mosfunksionimi i qarkullimit të valutës nga ofruesit deri te kërkuesit e saj.
n) "Tregu i brendshëm valutor" – është tregu ku kryhet aktiviteti i këmbimit valutor nga partnerët e tregtimit në Republikën e Shqipërisë.
o) "Kursi i këmbimit" – është çmimi i monedhës vendase kundrejt një njësijet të monedhës së huaj.
p) "Limit" – Shuma maksimale që bankat e nivelit të dytë janë të gatshme të tregtojnë me Bankën në një transaksion të vetëm dhe gjatë një dite. Limitet i komunikohen Bankës me anë të një

shkrese zyrtare në Departamentin e Operacioneve Monetare dhe mund të rishikohen jo më shpesh se një herë në gjashtë muaj.

q) "Komiteti"- është Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare në Bankë.

Neni 4
Objektivat e ndërhyrjes në tregun e valutor

Objektivat e ndërhyrjes së Bankës në tregun valutor janë:

a) shmangia e çrregullimeve në funksionimin e tij;
b) përshtatja e kursit të këmbimit me nivelin e përcaktuar nga faktorët bazë makroekonomikë; dhe
c) rritja e rezervës valutore.

KREU II
PROCESI I VENDIMMARRJES

Neni 5
Ndërhyrja për shmangien e çrregullimeve në tregun valutor

Për ndërhyrjen në tregun valutor për arritjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja "a" të kësaj rregulloreje, vendos Komiteti ose Guvernatori. Komiteti vendos mbështetur në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare.

Neni 6
Ndërhyrja për përshtatjen e nivelit të kursit të këmbimit

Për ndërhyrjen në tregun valutor, për arritjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja "b", vendos Këshilli Mbikëqyrës mbështetur në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare.

Neni 7
Ndërhyrja për rritjen e rezervës valutore

Për ndërhyrjen në tregun valutor për arritjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja "c" vendos Komiteti bazuar në programin monetar të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës, dhe mbështetur në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare.

Neni 8
Vendimet për ndërhyrje

1. Në vendimet që merr për ndërhyrjen në tregun valutor, sipas kësaj rregulloreje, Komiteti përcakton:

a) objektivin e ndërhyrjes;
b) llojin e ndërhyrjes (verbale ose/dhe me veprim); dhe
c) kohëzgjatjen e ndërhyrjes.

2. Komiteti ka të drejtë të përfshijë ose jo në vendimet e tij edhe elemente të tjera, të tilla si:
a) shumën maksimale të ndërhyrjes; dhe/ose
b) sterilizimin ose jo të ndërhyrjes.

3. Guvernatori vendos për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor vetëm në llojin e ndërhyrjes verbale.

Neni 9
Konfidencialiteti

1. Të gjitha propozimet dhe diskutimet për marrjen e një vendimi për të ndërhyrë në tregun valutor trajtohen si informacion "i rezervuar" bankar, në përputhje me rregulloren "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë".
2. Vendimet për të ndërhyrë në tregun valutor trajtohen si informacion "i rezervuar" sipas pikës 1 të këtij neni, deri në momentin e njoftimit dhe publikimit të tyre në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 10
Njoftimi dhe publikimi

1. Banka në raportet e saj periodike të publikuara, informon mbi ndërhyrjet në tregun valutor si dhe publikon shumën e ndërhyrjes së saj në përputhje me rregulloren "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës, i ndryshuar.
2. Banka publikon në faqen e saj në Reuters si dhe i komunikon bankave që nuk kanë Reuters, zyrave të këmbimit valutor me të cilat ka kontakte, kursin e këmbimit me të cilin realizon ndërhyrjet në tregun valutor, në rast se kursi i këmbimit është i të njëjtës vlerë për të gjithë partnerët.
3. Banka nuk publikon ose nuk komunikon kursin e ndërhyrjes në tregun valutor në rast se ndërhyrjet kryhen me kurse këmbimi me vlera të ndryshme, por publikon në faqen e saj në Reuters dhe i komunikon zyrave të këmbimit valutor me të cilat ka kontakte, faktin që ka ndërhyrë në tregun valutor.

KREU III
ZBATIMI I VENDIMEVE PËR NDËRHYRJE

Neni 11
Partnerët e tregtimit

1. Banka kryen ndërhyrjet në tregun valutor, si rregull me bankat e nivelit të dytë.
2. Në raste të veçanta, kur nuk funksionon tregtimi ndërmjet

bankave të nivelit të dytë Banka kryen ndërhyrjet në tregun valutor, nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor.

Neni 12
Instrumentet e ndërhyrjes sipas llojit

1. Banka kryen ndërhyrjet në tregun valutor nëpërmjet instrumenteve të mëposhtme:
a) Deklaratë në median e shkruar, median elektronike dhe/ose konferencë shtypi, të cilat përbëjnë ndërhyrjen verbale.
b) Kontaktim nga Banka i partnerëve të saj të tregtimit me synim lidhjen e marrëveshjeve spot dhe forward, që përbën ndërhyrje me veprim.

Neni 13
Realizimi i ndërhyrjes në tregun valutor

1. Ndërhyrja verbale në emër të Bankës realizohet në çdo rast nga Guvernatori i Bankës ose me autorizim të tij nga një prej anëtarëve të Komitetit.
2. Në emër të Bankës, ndërhyrja me veprim në tregun valutor në zbatim të vendimit të marrë sipas neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare në përputhje me nenin 8, shkronja "p" të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare".
3. Ndërhyrja në tregun valutor realizohet edhe me zyrat e këmbimit valutor vetëm në rastet kur tregu ndërbankar valutor nuk funksionon. Në rastet kur ndërhyrja realizohet me zyrat e këmbimit valutor, për formën e ndërhyrjes vendos Komiteti.
4. Departamenti i Operacioneve Monetare përcakton numrin e ndërhyrjeve në tregun valutor, në përputhje me vendimet e marra nga Komiteti për ndërhyrjet në tregun valutor.

Neni 14
Format e ndërhyrjes

Departamenti i Operacioneve Monetare, në përputhje me vendimin e Komitetit dhe duke synuar rritjen e efektivitetit të ndërhyrjes në tregun valutor, përcakton formën e ndërhyrjes, e cila përbëhet nga:

I. mënyra e përzgjedhjes së partnerëve të tregtimit;
II. përcaktimi i kursit të këmbimit; dhe
III. përcaktimi i shumës së ndërhyrjes.
I. Mënyra e përzgjedhjes së partnerëve të tregtimit është si vijon:
a) Departamenti i Operacioneve Monetare përcakton numrin e bankave të nivelit të dytë, të cilat do të jenë partneret e tregtimit të Bankës për ndërhyrjet në tregun valutor. Ky numër në çdo rast, nuk mund të jetë më i vogël se 4 (katër).

b) Kriteret për përzgjedhjen e bankave si partnere tregtimi janë:
i. konkurrueshmëria e kurseve të këmbimit;
ii. limitet e përcaktuara nga bankat e nivelit të dytë.
c) Në rast se bankat e nivelit të dytë nuk respektojnë limitin, në lidhje me transaksionet në të cilat Banka kërkon të hyjë me to, nëpërmjet një kursi të kuotuar prej tyre, Banka penalizon bankat e nivelit të dytë duke pezulluar kontaktimin me to.
d) Vendimi për penalizmin e bankës së nivelit të dytë në përputhje me shkronjën "c" të kësaj pike, merret nga Departamenti i Operacioneve Monetare, deri në mbledhjen e ardhshme të Komitetit, i cili vendos mbi kohëzgjatjen e mëtejshme të penalizimit, që në çdo rast nuk mund të tejkalojë 15 ditë gjatë të cilave Banka është e pranishme në tregun valutor.
e) Banka njofton bankën e nivelit të dytë me shkresë zyrtare për vendimin e Departamentit të Operacioneve Monetare dhe Komitetit në rast penalizmi.
II. Kursi i ndërhyrjes në tregun valutor përcaktohet nga:
a) kuotimet e bankave të nivelit të dytë;ose
b) kuotimi i Departamentit të Operacioneve Monetare; ose
c) kombinimi i shkronjave të mësipërme, "a" dhe "b".
III. Shuma e ndërhyrjes në tregun valutor përcaktohet nga:
a) limitet e miratuara të bankave të nivelit të dytë; ose
b) vendimi i Departamentit të Operacioneve Monetare; ose
c) kombinimi i shkronjave të mësipërme, "a" dhe "b".

Neni 15
Monedhat e ndërhyrjes

1. Për realizimin e ndërhyrjes në tregun valutor sipas kësaj rregulloreje, Departamenti i Operacioneve Monetare përdor monedhën e përbashkët evropiane (EUR) ose dollarin amerikan (USD).
2. Departamenti i Operacioneve Monetare nuk kuoton të dyja monedhat njëkohësisht.

Neni 16
Transaksionet tregtare

1. Banka ndërmerr transaksionet tregtare me Qeverinë dhe me institucione të tjera financiare ndërkombëtare si dhe me klientë të tjerë përveç bankave të nivelit të dytë vetëm pas marrjes së instruksioneve përkatëse në formë të shkruar ose mesazh SWIFT-i, nga përfaqësuesi i autorizuar i subjekteve të lartpërmendura.
2. Administratori përkatës i Bankës jep miratimin e tij për transaksionet tregtare të ndërmarra në ditën e marrëveshjes midis Bankës dhe subjekteve të cituara në pikën 1, të cilat kalojnë vlerën 1 milion usd ose vlerën e njëjtë në valutë tjetër. Për transaksione me vlera më pak se 1 milion usd, miratimi jepet nga drejtuesit e Departamentit të Operacioneve Monetare.

3. Kursi i këmbimit për qëllimin e ndërmarrjes së transaksioneve luhatet në vlerën rreth 0.50 për qind të kursit zyrtar të këmbimit të Bankës, në ditën e lidhjes së marrëveshjes.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

1. Ngarkohet Komiteti dhe Departamenti i Operacioneve Monetare për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të akteve të tjera të miratuara në zbatim të saj.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, vendimi nr. 38, datë 19.05.2005 për miratimin e rregullores "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore", i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 1, JANAR 2006

1. Vendim nr.01, datë 25.01.2006 "Për miratimin e deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.02, datë 25.01.2006 "Për miratimin e rregullores "Për ekspozimin e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë dhe administrimin e ruajtjen e tyre"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 25.01.2006 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri sh.a."".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 25.01.2006 "Për caktimin e kontrollorëve të jashtëm për auditimin e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 2, SHKURT 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.05, datë 08.02.2006 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.08, datë 08. 02. 2006 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.09, datë 08.02. 2006 "Për miratimin e dokumentit "Për misionin e Mbikëqyrjes"".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 08.02.2006 "Për prokurimin e drejtpërdrejtë të blerjes së karburantit, për nevoja të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 3, SHKURT 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 22.02.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin janar të vitit 2006"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 22.02.2006 "Për miratimin e rregullores "Për nxjerrjen e akteve juridike"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 22.02.2006 "Për një ndryshim në vendimin nr.79, datë 31.10.2005 të Këshillit Mbikëqyrës "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 4, MAJ 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.19, datë 15.03.2006 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit të Bankës së Shqipërisë".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.20, datë 15.03.2006 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 15.03.2006 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 12.04.2006 "Për një ndryshim në vendimin nr. 79, datë 31.10.2005 "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë"".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.31, datë 03.05.2006 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2006"".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.32, datë 03.05.2006 "Për miratimin e rregullores "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë"".
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.33, datë 03.05.2006 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 80 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Italo-Shqiptare sh.a., nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Capitalia S.p.a, Itali, tek Sanpaolo IMI S.p.A, Itali".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 5, MAJ 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.37, datë 24.05.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin prill të vitit 2006"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.38, datë 24.05.2006 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 60 për qind + 2 aksione të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., nga Kent Bank / Bayindir Bank A.S. tek Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim A.S., Turqi".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.40, datë 24.05.2006 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Statistikës të Bankës së Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.41, datë 24.05.2006 "Për "Prokurimin e drejtpërdrejtë" me kandidatin Kostare, për realizimin e shërbimit catering në Bankën e Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 6, QERSHOR 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.46, datë 28.06.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2006"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.48, datë 28.06.2006 "Për refuzimin e transferimit të pronësisë së aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Credins sh.a.".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 7, KORRIK 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 52, datë 12.07.2006 "Për rritjen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 12.07.2006 "Për "Disa ndryshime në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 8, KORRIK 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 56, datë 26.07.2006 "Për miratimin e "Deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2006"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 26.07.2006 "Për shtypjen e kartëmonedhës shqiptare, me kurs ligjor".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 26.07.2006 "Për rishtypjen kartëmonedhës shqiptare, me kurs ligjor".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 60, datë 26.07.2006 "Për miratimin e rregullores "Për shërbimin bibliotekar në Bankën e Shqipërisë"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 9, GUSHT 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 30.08.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2006"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 30.08.2006 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri"".

3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 63, datë 30.08.2006 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 11.25 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të bankës Procredit sh.a., nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim tek Procredit Holdomg A.g., Gjermani".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 64, datë 30.08.2006 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e botimeve në Bankën e Shqipërisë"".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 30.08. 2006 "Për miratimin e rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Investimit"".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 66, datë 30.08.2006 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të lekut në Bankën e Shqipërisë"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 10, SHTATOR 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.68, datë 13.09.2006 "Për një ndryshim në rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 69, datë 13.09.2006 "Për një ndryshim në rregulloren "Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 70, datë 13.09.2006 "Për disa ndryshime në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës"".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 27.09.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2006"".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 320 kopje